

## NE JEMI PËR TY PREZENT!

Merr guxim dhe bëj hapin e parë! Ne të mbështesim, të forcojmë dhe të këshillojmë, se si të mbrohesh në shtëpi kundër planeve për martesë të prindërve të tu. Së bashku ne gjejmë një zgjidhje - sado pa zgjidhje që mund të të duket ty situata. Nëse është e nevojshme, ne mund të gjejmë për ty edhe një strehim të mbrojtur dhe të fshehtë, ku ti do të gjeshe mbrojtje kundrejt kërcënimeve dhe dhunës.

### Egzistojnë Alternativa dhe rrugëdalje!

#### Ti dëshiron një person,

- » i cili të kupton ty dhe ankthet e tua, si edhe të mbështet ty?
- » i cili të merr seriozisht ty, dëshirat e tua dhe planet për të ardhmen?
- » me të cilin ti mund të flasësh hapur mbi gjithçka?
- » i cili mund të të ndihmojë, për të marrë vendimin më të mirë për ty?

#### Ne të ndihmojmë ty:

- » nëse ti ke një plan tjetër për jetën dhe prindërit këtë nuk e akceptojnë!
- » nëse ti ke frikë, se të martojnë kundër dëshirës tënde!
- » nëse ti tashmë je shtrënguar për një martesë të detyruar!

#### Ti vendos vetë!

[www.zwangsheirat-nrw.de](http://www.zwangsheirat-nrw.de)

## ÇFARË MUND TË BËSH?

Informohu në adresën [www.zwangsheirat-nrw.de](http://www.zwangsheirat-nrw.de), shko prej aty në këshillimin online ose na telefono neve!

E-Mail: [zwangsheirat@maedchenhaus-bielefeld.de](mailto:zwangsheirat@maedchenhaus-bielefeld.de)  
Telefon: 0521.521 68 79

### MÄDCHENHAUS

Bielefeld e.V.

Adresa: **Mädchenhaus Bielefeld e.V.**



Qendra e këshillimit të specializuar  
Kundër martesës së detyruar  
Renteistraße 14, 33602 Bielefeld

**Streha për vajza në nevojë dhe kriza:**

Telefon: 0521 . 2 10 10 (të kontaktueshëm ditë e natë)



Telefon 0521 . 521 68 79

# Kundër martesës së detyruar

Qendra e këshillimit të specializuar

لا للزواج بالإكراه! Zoraki evliliğe Hayır! No Forced Marriage!

JO martesës së detyruar! Ji zewaca bi zorë re na!



[www.zwangsheirat-nrw.de](http://www.zwangsheirat-nrw.de) Telefon 0521.521 68 79

**MÄDCHENHAUS**  
Bielefeld e.V.

gefördert vom:

Ministerium für Gesundheit,  
Emanzipation, Pflege und Alter  
des Landes Nordrhein-Westfalen



## ÇFARË ËSHTË NJË MARTESË E DETYRUAR?

### Një martesë e detyruar paraqitet:

- » kur prindërit e tu ose familja jote vendosin, se me kë duhet të martohesh ti.
- » kur askush nuk pyet, nëse dëshiron të martohesh ose cilin person dashuron.
- » kur nuk dëshiron të martohesh, kur ti nuk ke dhënë pëlqimin tënd, kur ti vihesh nën presion dhe ndjen detyrim.

**Ti ke të drejtën të vendosësh në mënyrë të lirë, nëse dhe me cilin dëshiron të martohesh!**

## Dashuria dhe martesat nuk duhet të kenë të bëjnë aspak me detyrimin!

**Asnjë fe nuk lejon martesat me detyrim!**



Telefon 0521 . 521 68 79

## EGZISTOJNË SHUMË MUNDËSI, SE SI VAJZAT TË DREJTOJNË JETËN E TYRE!

- » Qëllimi ynë është të forcojmë vajzat dhe gratë e reja, të cilat janë të kërcënuara ose prekura nga martesat e detyruar, në mënyrë që ato të jetojnë të vetëvendosura sipas dëshirave dhe përfytyrimeve të tyre vetjake.
- » Ne të informojnë dhe të mbështesim ty, nëse je e kërcënuar apo prekur nga një martesë me detyrim.
- » Ne jemi një ekip interkulturor grash dhe mund të këshillojmë në gjermanisht, anglisht, turqisht dhe gjuhën kurde. Për shqip dhe arabisht ne shfrytëzojmë shërbime përkthyesish.
- » Këshillimi është falas dhe anonim dhe mund të zhvillohet online, në telefon si edhe ballë për ballë.
- » Edhe djem e burra të rinj të kërcënuar apo prekur mund të na drejtohen. Në rast nevojë ne i përcjellim ata më tej në institucionet e përshtatshme këshilluese.



[www.zwangsheirat-nrw.de](http://www.zwangsheirat-nrw.de)

## OFERTA TË TJERA

- » Ne këshillojmë edhe të afërm dhe persona të besuar, si edhe ndihmëse e ndihmës profesionale, të cilët janë të konfrontuar profesionalisht me temën e martesës së detyruar dhe që kërkohen këshillim e mbështetje.
- » Ne ofrojmë organizime informative, trajnime dhe workshops për multiplikatorët.
- » Ne zhvillojmë organizime preventive falas në të gjitha format shkollorë mbi temën FORCOJMË VAJZAT - në mbrojtje kundër martesës së detyruar në Vestfalinë Perëndimore NRW.
- » Informacione të mëtejshme dhe rekomandime për veprim gjenden në adresën [www.zwangsheirat-nrw.de](http://www.zwangsheirat-nrw.de) në gjuhë gjermane.

**Shtëpia e vajzave Bielefeld** është një shoqatë me dobi publike, e cila i ka vënë qëllim vetes të përmirësojë kushtet e jetesës së vajzave dhe grave të reja në të gjitha fushat e jetës. Shoqata si bartëse e njohur e ndihmës për të rinj, projektonte oferta partiake për vajza dhe gra të reja në nevojë dhe situata krizash.

[www.maedchenhaus-bielefeld.de](http://www.maedchenhaus-bielefeld.de)

Telefon 0521 . 521 68 79